



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 1325

NR. VENDIMI 786

**VENDIM**  
**“NE EMER TE REPUBLIKES”**

*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :*

**Gjyqtar : ERVIN POLLOZHANI**

asistuar nga sekretare gjyqesore **Lusjana Idrizi**, sot më datë **08. 02. 2016**, mori në shqyrtim në seancë gjyqesore publike, çështjes civile me **Nr. 8744/1325 Regj. Themeltar** që i përket :

**PADITËSE :**

**\*\*\*, e bija e \*\*\* dhe \*\*\*, dtl. \*\*\*, lindur ne \*\*\* dhe banuese në \*\*\*, e përfaqësuar ne gjykim me prokurë të posaçme Nr. \*\*\* nga av. \*\*\* (në mungesë vetëm në shpalljen e vendimi).**

**I PADITUR :**

**\*\*\*, lindur në \*\*\* e banues në \*\*\*, me adresë \*\*\*, i perfaqesuar në gjykim me prokurë të posaçme Nr\*\*\* nga av. \*\*\* (në mungesë vetëm në shpalljen e vendimi).**

**PERSONA TE TRETE :**

**SHKOLLA E MAGJISTRATURES**, me adrese Rruga e Elbasanit, prane Fakultetit te Gjeologji-Minierave Tirane, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim perfaqesimi Nr. \*\*\* nga znj. \*\*\* (në mungese).

**QENDRA E SHERBIMEVE DHE PRAKTIKAVE LIGJORE TE INTEGRUARA**, me adrese Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla 5, Ap. 50 Tirane, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim perfaqesimi dt. \*\*\* nga znj. \*\*\* (në mungese).

**OBJEKTI :**

**1.** Detyrimin e pales se paditur te shperbleje demin pasuror dhe moral te shkaktuar nga botimi ne menyre te padrejte, nen emrin e tij, dhe duke shkelur te drejten autorit, te shkrimit me titull “Hetimi dhe gjykimi i veprave penale te trafikimit” ne “Manualin per identifikimin, trajtimin dhe mbrojtjen e

viktimave te trafikimit te qenieve njerezore”, e botuar nen siglen e Qendres se Sherbimeve dhe Praktikave Ligjore te Integruara (konkretisht faqe \*\*\*) në shumën totale prej \*\*\* lekë.

**2.** Marrjen e masës së perkohshme nga ana e gjykates së konfiskimit të të gjitha kopjeve në qarkullim të këtij manuali.

**3.** Asgjësimin e fletëve të kopjeve të “Manualit për identifikimin, trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerezore”, e botuar në siglen e Qendres së Sherbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara” nga faqe \*\*\*, me shpenzimet e pales së paditur, \*\*\*.

### **BAZA LIGJORE :**

Neni 58 i Kushtetutes. Neni 32/a K. Pr. Civile. Nenet 608, 609, 610, 625 të K. Civil, Nenet 2, 3, 5, 7/b, 10, 12, 13, 16, 118, 119, 120, 121, 122, 127, 128, 129 të Ligjit Nr. 9380, dt. 28. 04. 2005 “Për të drejtat e autorit dhe për të drejtat e tjera të lidhura me të”.

Gjykata, pasi administroi provat shkresore, degjoi pretendimet perfundimtare të perfaqesuesit të paditeses, i cili kërkoi: *Pranimin e kerkese-padise sipas objektit të saj*, pretendimet perfundimtare të perfaqesuesit të pales së paditur, i cila kërkoi: *Rrezimin e kerkese-padise si të pa bazuar në prova dhe në ligj*, pasi e shqyrtoi çështjen në teresi në mungesë të personave të trete, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor,

### **VËREN :**

Se, paditësja \*\*\* i është drejtuar nepermjet perfaqesuesit të saj kesaj gjykate, me kërkesë-padine sipas objektit të siperpermendur.

Fillimisht kjo çështje është gjykuar si e tille nga kjo gjykate, e cila me vendimin e saj Nr. \*\*\* dt. \*\*\* ka vendosur: “*Rrezimin e kerkese-padise si të pa bazuar në ligj dhe në prova...*”.

Ndaj këtij vendimi pala paditese ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tirane e cila me vendimin e saj Nr. \*\*\* dt. \*\*\* ka vendosur: “*Prishjen e vendimit Nr. \*\*\* dt. \*\*\* të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Tirane dhe dergimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykate, por me tjetër trup gjykues*”. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi (Nr. \*\*\*) është pershkruar se ky vendim (Nr. \*\*\*) duhet të priset për shkak të mos formimit të drejte të ndergjyqesise. Kjo pasi si pale ndergjyqese në këtë gjykim duhet të ishin dhe Shkolla e Magjistratures dhe Qendra e Sherbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara si subjekte që terheqin interesa në këtë gjykim (faqe 6 e vendimit).

Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë e cila me vendimin e saj Nr. \*\*\* dt. \*\*\* ka vendosur: “*Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur \*\*\* kundër vendimit Nr. \*\*\* dt. \*\*\* të Gjykates së Apelit Tirane*”.

Pas ardhjes se kesaj çeshtjeje per rigjykim, fillimisht nga pala paditese, ne permbushje dhe te detyrave te lena nga Gjykata e Apelit Tirane me vendimin Nr. \*\*\* dt. \*\*\*, u kerkua ne veshtrim te Nenit 192 te K. Pr. Civile qe ne gjykim te thirreshin me cilesine personave te trete Shkolla e Magjistratures si dhe Qendra e Sherbimeve dhe Praktikave Ligjore te Integruara, kerkim ky qe u pranua si i tille nga gjykata pasi u gjet i bazuar ne ligj.

Me tej pala paditese kerkoi ne mbeshtetje te Nenit 185 te K. Pr. Civile qe te ndryshonte objektin e kerkese-padise sa me siper pershkruhet ne pjesen hyrese te vendimit, kerkim ky qe u pranua si i tille nga gjykata nisur nga fakti se eshte ne diskrecionin e kesaj pale disponimi mbi objektin e saj.

Lidhur me kerkimin e pikes se dyte te objektit te kerkese-padise (sigurimin e padise), gjykata nga ana e saj disponoi me vendimin e rrezimit te ketij kerkimi ne seancen pregatitore te dt. 29. 10. 2015, pasi e gjeti kete kerkim te pa bazuar ne ligj dhe ne prova.

Nderkohe qe nga pala paditese ky kerkim u perserit si i tille formalisht ne momentin procedural te ndryshimit te objektit te kerkese-padise duke u kerkuar perseri si pjese e objektit te kerkese-padise.

Pas kalimit te ketyre momenteve procedurale, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kesaj çeshtjeje te paraqitur per gjykim dhe bazuar ne Nenit 36, 59 te K. Pr. Civile, konstatoi se çeshtja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil.

Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë të Nenit 41 të K. Pr. Civile: *«Në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera»*. Meqënëse ndodhemi përpara një mosmarrëveshjeje me karakter civil që rrjedh nga marrëdhënia juridiko-civile e demit jashtkontraktor, gjykata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencen tokesore ne baze te Nenit 42 te K. Pr. Civile: *«Padite ngrihen ne gjykatën e vendit ku i padituri ka vendbanimin ose vendqendrimin e tij dhe kur keto nuk dihen ne gjykatën e vendit ku ai ka banesen e perkohshme»*. Neni 48 i K. Pr. Civile percakton se : *«Padite nga shkaktimi i demit mund te ngrihen si ne gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri, ashtu dhe ne gjykatën e vendit ku eshte shkaktuar demin»*. Duke gene se i padituri, vendqendrimin e ka ne Tirane, kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane per shqyrtimin e kesaj çeshtjeje objekt konflikti.

Pala paditese, bazuar ne Nenin 32/a te K. Pr. Civile legjitimohet t'i drejtohet gjykates me kete kerkese-padi ne baze te se ciles do te perfitoje te drejta personale – pasurore juridike civile.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të neneve 71, 72 dhe 73 të K. Pr. Civile, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palet prezent në gjykim.

Në bazë të nenit 35 të K. Pr. Civile gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

*Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se:*

Paditësja në cilësinë e ish-studentes së Shkollës së Magjistraturës Tiranë, sot me detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor \*\*\*, në vitin \*\*\* ka mbrojtur temën “*Trajtimi i viktimave të trafikimit. Standart i nevojshëm në dhënien e drejtësisë*”, me udhëheqës teme të paditurin \*\*\*, pedagog i jashtëm pranë kësaj shkolle dhe gjyqtar në Gjykatën e \*\*\*, qe ne kohen e krijimit te kesaj gjykate e ne vijim.

Pala paditëse deklaroi se gjatë një seminari pjesë e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, është vënë në dijeni të “*Manualit per identifikimin, trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave te trafikimit te qenieve njerezore*”, pjesë e të cilit ishte edhe tema “*Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të trafikimit*”.

Paditësja deklaroi se kjo temë e trajtuar në manual në faqet \*\*\* të tij, është pjesë nga tema e saj e diplomës dhe është marrë nga i padituri pa lejen e autores. Sipas saj kjo pjese e temes se trajtuar nga i padituri eshte kopjuar ne menyre te plote nga ana e tij pa asnje ndryshim qofte strukturor, duke perdorur njekohesisht dhe te njejtat referenca ne footnote ne menyre identike siç ato te perdorura nga ana e paditeses ne temen e diplomimit ne Shkollen e Magjistratures. Ky manual sipas saj, është trajtuar në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe për këtë shkak, dëmi që i është shkaktuar nga ky botim është shumë i madh.

Paditësja pretendoi në gjykim se këtë pjesë të veprës së saj, pala e paditur e ka përdorur edhe në trajnime të tjera, duke marrë edhe shpërblimin që i takonte paditëses \*\*\*. Kjo palë deklaroi se i është drejtuar jashtëgjyqësisht të paditurit duke i kërkuar që të pushojë cënimin e të drejtës së autorit të temës së saj, por prej këtij të padituri, është refuzuar një fakt i tillë. Pala paditëse pretendoi se veprimet e të paditurit kanë cënuar nenet 10, 11, 12 të Ligjit Nr. 9380 dt. 28. 04. 2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” dhe në bazë të neneve 118, 119, 120, 121, 122, 127 dhe 129 të këtij ligji, kërkoi shpërblimin e dëmit pasuror dhe jo-pasuror të shkaktuar si rezultat i shkeljes së të drejtës së autorit dhe konfiskimin e shkatërrimin e kopjeve të veprës.

Sipas paditëses, ligji specifik i mbrojtjes së të drejtës së autorit, është edhe baza ligjore mbi të cilën janë mbështetur pretendimet e saj dhe në momentin kur paditësja ka provuar se vepra e saj “temë diplome” është punim origjinal, ka përfunduar edhe detyrimi i të provuarit për këtë palë.

Lidhur me provat e paraqitura nga pala e paditur, pala paditëse deklaroi se këtyre provave iu mungon si origjinaliteti ashtu edhe fuqia provuese. Kjo per shkakun se: a) *Nuk janë të përpiluara si shkresa të thjeshta; b) Nuk mund të paraqiten si provë nga personi që i ka hartuar ato; c) Nuk kanë datë të saktë dhe nuk vërtetojnë momentin kur ato janë përpiluar; ç) Nuk janë origjinale; d) Nuk kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi.*

Në këto kushte, pala paditëse pretendoi se këto prova nuk duheshin administruar nga gjykata pasi nuk i shërbenin gjykimit lidhur me shkeljen e të drejtës së autorit për të dhe për sa më sipër, paditësja kërkoi pranimin e kërkesë-padisë sipas objektit të saj.

Nga ana e tij pala e paditur \*\*\* deklaroi se kërkesë-padia është e pambështetur në ligj e në prova për sa më poshtë vijon:

Nuk u provua momenti i konstatimit te cenimit te se drejtes se pronesis se paditeses mbi tezen ku ajo mbane autoresine, nga ana e pales se paditur, pra edhe momenti i lindjes se te drejtes se saj per kerkim shperblimi pasuror.

Nuk u soll ne proces asnje prove shkresore qe te provohet demi i shkaktuar pales paditese nga publikimi i Manualit, dem ky qe ne aspektin pasuror do te perfshinte demin real dhe ate te fitimit te munguar.

Paditesja duke iu referuar Manualit, pretendon se shkrimi i botuar nga pala e paditur ne te, eshte veper e saj, e shkeputur nga punimi i saj Tema : « *Trajtimi i viktimave te trafikimit. Standarti i nevojshem ne dhenien e drejtesise* ». Ajo pranon faktin e bashkeautoresise, duke ceduar nga autoresia e vetme, por nuk provon dot se cila pjesë e punimit të saj është hartuar me ndihmën e të paditurit në gjykim.

Pala e paditur ne proces solli fakte ne cilesine e proves me qellim provimin se pjesa "*Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të trafikimit*" e manualit "*Manuali për identifikimin, trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit*" është punim i tij dhe një punim i cili mbështetet në ekspertizën e tij të mëparshme në këtë fushë, në punime të tjera të mëparshme të të njëjtës temë si dhe në materiale e burime shkencore-legale, për të cilat asnjëra nga palet nuk ka të drejtën e autorit.

Ne cilesine e proves nga pala e paditur, u depozituan ne proces materiale shkencore baze, mbi te cilat eshte mbeshtetur i paditur në hartimin e kësaj pjese të manualit dhe kane sherbyer si burime referimi në shkrimin « *Hetimi dhe gjykimi i veprave penale te trafikimit* » pjesë e « *Manualit per identifikimin, trajtimin dhe mbrojtien e viktimave te trafikimit te genieve njerezore* ».

Sipas të paditurit, bazuar ne provat e sipercituara, provohet se shkrimi « *Hetimi dhe gjykimi i veprave penale te trafikimit* » është hartuar nga pala e paditur dhe ky shkrim eshte produkt i punes kerkimore e shkencore te pales se paditur, e materializuar ne aktivitetet e mëparshme të tij.

Në këto kushte, i padituri \*\*\* kërkoi rrëzimin e kërkesë-padisë si të pambështetur në ligj e në prova.

Nga ana e personit te trete, Shkolla e Magjistratures, ne seancen e vetme gjyqesore qe mori pjese paraqiti qendrimin me shkrim, ku sipas saj: *Nepermjet rregullores se brendshme te Shkolles se Magjistratures miratuar me vendimin Nr. 6 dt. 19. 06. 2007 te Keshillit Drejtues te Shkolles, i ndryshuar, jane vendosur rregullat normative te marredhenieve qe krijohen midis shkolles dhe subjekteve pjesemarrese ne te. Pjese e ketyre rregullave eshte dhe marredhenia qe krijohet midis shkolles dhe kandidateve magjistrate duke percaktuar te drejtat dhe detyrimet per secilen pale. Ne kuader te metodologjise dhe organizimit te trajnimit fillestar kandidati per magjistrat ka per detyre pregatitjen dhe mbrojtjen e temes se diplomes te miratuar nga Drejtoria e Shkolles ne fillim te çdo viti kalendarik. Tema pergatitet nen udheheqjen e Shkolles se Magjistratures e cila zgjedh nje udheheqes me eksperience praktike dhe shkencore.... Ne lidhje me çeshtjen objekt shqyrtimi nga verifikimet e kryera ne Shkolle, nuk rezulton te jete depozituar prane saj asnje kerkese per marrjen e lejes per perdorim apo botim*

*nga palet ndergjyqese ne proces, as nga udheheqesi dhe as nga botuesi.*

Nga ana e saj gjykata referuar objektit dhe bazez ligjore te kerkese-padise si dhe përpos shpjegimeve të palëve ndërgjyqëse çmon se referuar Nenit 6 të K. Pr. Civile percaktohet se: *“Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”*. Nga ana tjetër Neni 16/1 përcakton se *“Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore..... Gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës. Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm”*. Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre. Ne kete kuptim gjykata referuar Nenit 17 te K. Pr. Civile ka orientuar palen paditese duke e ftuar ate te japi shpjegime nga pikepamja e se drejtes qe ajo e çmon te nevojshme per zgjidhjen e mosmarreveshjes, pikerisht per dispozitat proceduriale ku bazohet paditesi ne pretendimin e shkaktimit te demit material dhe jo pasuror ndaj tij.

Lidhur me themelin e kerkimit te objektit te kerkese-padise konflikti gjyqesor buron nga marrëdhënia juridike e demshperblimit jashte-kontraktor per shkak te cenimit te se drejtes se autorit, e cila gjen rregullim ne Nenet 608, 625/a e vijues te K. Civil. Ky nen (608) jep përkufizimin e shkaktimit të dëmit. Sipas kësaj dispozite: *“Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkakton tjetrit një dëm në personin ose pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.”*

Neni 609 i K. Pr. Civile percakton se: *“Demi duhet te jete rrjedhim i drejtperdrejt dhe i menjehershem i veprimit ose mosveprimit te personit”*.

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se katër janë kushtet që të lindi detyrimi nga shkaktimi i dëmit jashtë kontraktor. Konkretisht: a) të ekzistojë dëmi (që në rastin objekt gjykimi, lidhet me cenimin e nderit dhe personalitetit të personit); b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose mosveprimit; c) ekzistenca e fajit; d) lidhja shkaksore midis veprimit ose mosverimit dhe pasojës (dëmit ) të ardhur. Të katër këto kushte duhet të qëndrojnë bashkarisht (në mënyrë kumulative) që të ekzistojë detyrimi.

*Veprimi i paligjshem* ne shkaktimin e demit cilesohet nje kategori objektive, shfaqja e kundraligjshme e vullnetit te subjektit te se drejtes qe sjell si pasoje shkeljen ose cenimin e te drejtave, lirive dhe interesave te te treteve qe mbrohen nga rendi juridik dhe zakonet e mira. Kundraligjshmeria e sjelljes se subjektit shkaktar te demit cenon marrëdhëniet juridike, qe gezojne mbrojtje nga Kushtetuta, aktet nderkombetare, ligjet dhe aktet nenligjore, te cilat njohin dhe garantojne te drejtat e personave fizik dhe juridik ne raport me njeri-tjetrin dhe pushtetin publik.

*Faji* eshte qendrimi subjektiv i personit shkaktar te demit ne raport me veprimin e kundraligjshem dhe pasojat qe vijne prej tij, qe nenkupton vullnetin e brendshem psikik per te kryer veprimin, per te siguruar

ardhjen e pasojave ose lejimin e ardhjes se tyre.

*Lidhja shkakesore* vleresohet si ekzistenca e lidhjes objektive, te drejtperdrejte dhe te pavarur nga vullneti i subjektit shkaktar te demit mes veprimit te kundraligjshem dhe pasojes se ardhur. Lidhja shkakesore verteton lidhjen mes tre elementeve objektive dhe subjektive te faktit te paligjshem; konkretisht sjelljes se paligjshme, fajit dhe pasojes se ardhur, pra demit te shkaktuar ne pasurine, shendetin ose personalitetin e subjektit te demtuar. Elementi i lidhjes shkakesore mbeshetet ne parimin *condicio sine qua non* sipas te cilit nuk do te vertetohej ardhja e pasojes se demshme nese nuk do te kishte ndodhur shkakku, sjellja e paligjshme dhe faji per shkaktimin e demit.

*Demi* i cili mund te kete karakter pasuror ose jo-pasuror.

Neni 625 i Kodit Civil parashikon se: *“Personi qe pesson nje dem, te ndryshem nga ai pasuror, ka te drejte te kerkoje te shperblehet kur: a) ka pësuar nje demtim te shendetit ose eshte cënuar ne nderin e personalitetit te tij.*

Neni 640 i K. Civil parashikon se: *“Demi pasuror qe shperblehet perbehet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar. Shperblehen gjithashtu shpenzimet e kryera ne menyre te arsyeshme per te shmangur ose pakësuar demin, ato qe kanë qene te nevojshme per te percaktuar pergjegjesine dhe masen e demit, si dhe shpenzimet e arsyeshme te kryera per te siguruar shperblimin ne rruge jashtegjyqesore”.*

Gjykata vlereson se analiza e katër elementëve te parashtruar me lart (Neni 609 i K. Civil), duhet bere ne linje kronologjike, duke shqyrtuar nese permbushet secili element me vehte.

Paraprakisht perpara kesaj analize pyetjet qe shtrohen per diskutim fillimisht jane:

- *A jemi perpara cenimit te se drejtes se autorit nga pala e paditur;*
- *A i eshte shkaktuar palës paditese dem pasuror dhe jo-pasuror;*
- *Në rast se palës paditese i eshte shkaktuar nje dem i tille, cilat do te jene kriteret mbi te cilat duhet te mbeshetet gjykata per te percaktuar demshperblimin perkatës?*

Neni 2 i Ligjit Nr. 9380/2008 percakton se: *Ky ligj zbatohet per personat fizike a juridike, vendas ose te huaj, qe ushtrojne veprimtari krijuese, tregtare, prodhuese apo çdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, perdorimi a tjetërsimi te veprave letrare, artistike ose shkencore ne territorin e Republikës së Shqipërisë.*

Neni 3 i ligjit percakton se: *“Vepër artistike” eshte çdo krijim origjinal, intelektual i nje personi fizik, i materializuar, pavarësisht nga forma a menyra e te shprehurit, qe ka per qellim te preke ndjesite e njeriut”.*

Neni 4/10 i ligjit percakton se: *“Bashkautorësi” nenkupton bashkimin ose shoqerizimin e disa autorëve ne krijimin e nje vepre.*

Neni 5 i ligjit percakton se: *“Autor/ë eshte personi ose jane personat fizike, qe krijojne nje vepër letrare, artistike ose shkencore. 2. Autor i veprës eshte çdo person fizik ose nje grup personash fizike, me emrin e te cilit/ve vepre eshte shfaqur per here te pare ne publik, me perjashtim te rastit kur*

*vërtetohet se autorësia i përket një ose disa personave fizikë, të tjerë nga ata që kanë emrat në vepër.”*

Neni 6 i ligjit përcakton se: “1. Vepër e përbashkët është puna krijuese e disa autorëve në bashkëpunim. 2. Bashkautorësia rregullohet me marrëveshje ndërmjet palëve ose sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. 3. E drejta e autorit në veprën e përbashkët u përket autorëve, të cilët me marrëveshje zgjedhin njërin prej tyre si autorin kryesor. 4. Autorët e një vepre të përbashkët e shfrytëzojnë veprën në bazë të marrëveshjes ndërmjet tyre. Refuzimi i marrëveshjes nga secili autor i veprës së përbashkët justifikohet në mënyrën e duhur. 5. Autorët e një vepre të përbashkët, nën rezervën e çdo marrëveshjeje ndërmjet tyre, gëzojnë të drejtën të shfrytëzojnë veças kontributin e tyre, me kusht që të mos cenojnë shfrytëzimin e veprës si një të tërë. 6. Në rast shfrytëzimi të veprës së krijuar në bashkëpunim, autorët, në bazë të marrëveshjes ndërmjet tyre, gëzojnë të drejtën e një shpërblimi në kushtet dhe masat që ata vetë kanë rënë dakord. Në rast se kjo marrëveshje nuk ekziston, shpërblimi ndahet në pjesë, sipas kontributit të secilit autor, ose në pjesë të barabarta, kur kontributi individual nuk mund të përcaktohet.

Neni 7 përcakton se: *Objekt i të drejtës së autorit në fushën e letërsisë, artit ose shkencës, produkt i punës krijuese të mendjes së njeriut, pa marrë parasysh mënyrën e krijimit, mjetet ose format praktike të të shprehurit dhe pavarësisht nga vlerat e tyre ose destinacioni, janë: dh) krijimet fotografike dhe çdo krijim tjetër, që shprehet në mënyra të ngjashme me fotografine”.*

Neni 8 i ligjit përcakton se: “1. Objekt i të drejtës së autorit janë edhe: a) veprat e prejardhura, të cilat, pa cenuar të drejtat e autorit të një vepre, krijohen duke filluar nga një ose disa vepra që kanë ekzistuar më parë, në mënyrë të veçantë: përkthimet, përshtatjet, ilustrimet, krijimet dokumentare, aranzhimet muzikore dhe çdo transformim i një vepre letrare, artistike a shkencore, produkt i punës krijuese;

Neni 10 i ligjit përcakton se: “Autori i një vepre gëzon të drejtat vetjake jopasurore: a) të vendosë nëse, në ç’mënyrë dhe kur vepra e tij do t’i paraqitet publikut, si dhe vendin ku vepra e tij do të paraqitet për herë të parë në publik; b) të kërkojë që t’i njihet autorësia mbi veprën, veçanërisht e drejta që emri i tij të shkruhet në kopjet e veprës dhe, kur e lejon praktika e sipas traditës, t’i bashkëngjitet veprës, kur ajo përmendet publikisht; c) të vendosë në emrin e kujt do të paraqitet vepra e tij te publiku, si dhe të drejtën që të mbetet anonim; ç) të kërkojë respektimin e tërësisë së veprës dhe të kundërshtojë çdo heqje ose ndryshim, që cenon nderin dhe emrin e tij;...

Neni 11 i ligjit përcakton se: “1. Të drejtat vetjake jopasurore nuk përbëjnë objekt dorëheqjeje. 2. Këto të drejta janë të patjetërsueshme dhe nuk mund të parashkruhen”.

Neni 12 i ligjit përcakton se: *Autori gëzon të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të veprës së vet në çdo formë dhe mënyrë. 2. Autori i një vepre letrare, artistike ose shkencore gëzon të drejtën e shpërblimit për çdo rast dhe për çdo mënyrë shfrytëzimi të veprës, të lejuar apo jo nga vetë ai, edhe nëse heq dorë nga kjo e drejte”.*

Neni 13 i ligjit përcakton se: “Autori gëzon të drejtën ekskluzive për ta shfrytëzuar veprën e vet në formë materiale dhe jomateriale. 2. Autori gëzon të drejtën ekskluzive”.



Neni 22 i ligjit percakton se: "Origjinalitet i një vepre" nënkupton shfaqjen e botës së brendshme të një autori, pa kopjuar, në tërësi ose në një pjesë të rëndësishme, një krijim tjetër.

Neni 27 i ligjit percakton se: "Botues" është personi fizik a juridik, që merr nismën dhe realizon, nën përgjegjësinë e vet, riprodhimin mekanik dhe vënien në dispozicion të publikut të një vepre, me çdo mjet a mënyrë.

Neni 39 i ligjit percakton se: "Shpërndarje e veprës" nënkupton vënien në dispozicion të publikut të origjinalit ose të kopjeve të veprës, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimit, qiradhënies, huadhënies etj.

Neni 118 i ligjit parashikon se: 1. Çdo person, i cili pretendon se një veprim i caktuar i cenon të drejtën e shfrytëzimit, që e gëzon sipas dispozitave të këtij ligji, ose që përpiket të ndalojë vazhdimin a përsëritjen e veprimit cenes, të kryer më parë, ka të drejtë të fillojë procedurat ligjore nëpërmjet organeve përkatëse, për t'u siguruar që e drejta e tij të njihet dhe veprimi cenes të ndalohet. 2. Procedurat mbështeten në dispozitat e këtij seksioni dhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Neni 120 i ligjit parashikon se: 1. Çdo person, të cilit i cenohet ushtrimi i të drejtave të tij për shfrytëzimin e veprës, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të nisë procedim ligjor në organet gjyqësore kompetente, për të kërkuar shkatërrimin ose asnjësimin e materialeve dhe/ose të pajisjeve dhe shpërblim për dëmin e shkaktuar. 2. Vendimi i shkatërrimit ose i asnjësimit të materialeve dhe/ose të pajisjeve, pjesë përbërëse të veprimit cenes, merret vetëm nga gjykata pas kryerjes së aktit të ekspertimit dhe të vlerësimit nga specialistët e caktuar për këtë qëllim nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, të cilët duhet të shprehen për cilësitë e materialeve dhe/ose të pajisjeve, sipas kërkesave të dispozitave të mëposhtme.

Neni 121 i ligjit parashikon se: 1. Shkatërrimi ose asnjësimi i përcaktuar në nenin 120 të këtij ligji kryhet mbi specimenet dhe kopjet e riprodhuara a të shumëfishuara në kundërshtim me ligjin apo mbi pajisjet ose mjetet e përdorura për riprodhim a shumëfishim, të cilat, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të përdoren për riprodhimin a shumëfishimin e veprave të tjera. 2. Nëse një pjesë e specimenit, kopjes, pajisjes ose mjetit të përdorur në këtë rast mund të përdoret për riprodhimin a shumëfishimin e veprave të tjera, pala e interesuar ka të drejtë të kërkojë ndarjen e një pjese të tillë në interes të saj, kundrejt shpenzimeve përkatëse për shmangien e plotë të mundësisë së ripërdorimit. 3. Nëse specimeni, kopja, pajisja ose mjeti, për të cilin është kërkuar shkatërrimi ose asnjësimi ka, në bazë të vlerësimit të bërë nga specialistët e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, vlera të veçanta artistike ose shkencore, gjykata vendos, kryesisht, depozitimin në një muze publik. 4. Personi, të cilit i janë prekur interesat, ka të drejtë, në çdo kohë, të kërkojë zotërimin, kundrejt vlerës, të specimenit, kopjes, pajisjes ose mjetit, për të cilin është kërkuar shkatërrimi ose asnjësimi, e cila i zbritet vlerës së përcaktuar për shpërblimin e dëmit. 5. Dispozitat për shkatërrimin apo asnjësimin e specimenit, të kopjes së veprës ose për kalimin e tyre në zotërim të personit të cenuar në ushtrimin e të drejtës së shfrytëzimit të veprës nuk zbatohen për specimenin ose kopjet e marra në mirëbesim apo për përdorim vetjak.

Neni 122 i ligjit parashikon se: Shkatërrimi ose asnjësimi nuk mund të kërkohet vitin e fundit të afatit të të drejtës së shfrytëzimit, por mund të vendoset, në çdo kohë, sekuestrimi i veprës ose i kopjeve të saj, deri në

*mbarim të këtij afati. Sekuestrimi lejohet edhe para afatit të sipërpërmendur, nëse është shpërblyer dëmi i shkaktuar nga cenimi i të drejtës së shfrytëzimit.*

Neni 127 i ligjit parashikon se: *Dispozitat e mëposhtme, që kanë për objekt ushtrimin e të drejtave vetjake jopasurore dhe mbrojtjen e tyre, zbatohen mutatis mutandis, sipas dispozitave të mësipërme, për aq sa natyra e këtyre të drejtave e lejon këtë zbatim.*

Neni 128 i ligjit parashikon se: *Veprimet në mbrojtje të të drejtave vetjake jopasurore, që lidhen me autorësinë në një vepër, kanë si qëllim asnjësimin ose shkatërrimin e kopjes a të prodhimit të kësaj vepre, vetëm nëse dëmi nuk mund të riparohet me anë të shtesës, të shënimit në vepër ose të reklamës për sa i përket autorësisë.*

Neni 129 i ligjit parashikon se: *Veprimet në mbrojtje të të drejtave vetjake jopasurore, që lidhen me cenimin e tërësisë së një vepre, kanë si qëllim asnjësimin ose shkatërrimin e kopjes ose të prodhimit të kësaj vepre të deformuar, të copëtuar ose të ndryshuar, vetëm nëse është materialisht e pamundur që kopja a riprodhimi i saj të kthehet në formën origjinale, me shpenzimet e palës që kundërshton asnjësimin ose shkatërrimin,*

Perpos kuadrit ligjor të sipërpërmendur, lidhur me mosmarreshjen dhe kerkimet e padise, gjykata arsyeton se gjejne zbatim rregullimet e pergjithshme të K. Civil lidhur me institutin e shkaktimit të dëmit në dy format e tij (dëm pasuror dhe jo-pasuror) dhe mbrojtjen e posaçme të të drejtës së autorit, parashikuar në Ligjin Nr. 9380 dt. 28.04.2005.

Ne gjykimet me objekt detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit, nëse paditesi kërkon demshperblimin “*per te gjitha demet*” apo “*per te gjitha demet pasurore e jopasurore*”, kjo menyre kerkimi perben disponimin e tij per kerkimin e demshperblimit per çdo figure te demit pasuror e jopasuror. Por, nëse kerkese-padia permban kerkime per demshperblimin e figurave konkrete te demit jashtekontraktor, gjykata ka detyrimin t’i permbahet ne gjykim dhe vendim ketyre kerkimeve specifike.

Ne rastin e dëmtimit të të drejtës së autorit nga fakti i paligjshëm, sikurse pretendohet se ka ndodhur në çështjen objekt i këtij gjykimi, paditësi që ka pësuar këtë dëm, ka legjitimim aktiv për kerkimin e demshperblimit të demit pasuror të pësuar.

Neni 608 i K.Civil parashikon demshperblimin për demet jashtekontraktore të pësuar nga vete i demtuari “*ne personin ose ne pasurine e tij*”.

Ne rastin e cënimit të të drejtës së autorit nga fakti i paligjshëm, sikurse pretendohet se ka ndodhur në çështjen objekt i këtij gjykimi, kjo shtetase (paditësja \*\*\*) si subjekt që pretendon drejtpërsëdrejt se është e cënuar, ka legjitimim aktiv për kerkimin e demshperblimit të demit pasuror të pësuar.

Sipas nenit 608 të K.Civil: “*Personi që në menyre të paligjshme dhe me faj, i shkaktonte tjetrit një dëm në personin dhe pasurinë e tij, detyrohet të shperblejë demin e shkaktuar*”. Kjo dispozite parashikon faktin juridik njerezor të sjelljes së paligjshme dhe me faj të një personi që i shkaktonte dem një personi tjetër. Nëse vërtetohet fakti i paligjshëm dhe lidhja shkakesore e tij me demin, lind marrëdhënia e detyrimit, e drejta subjektive e personit të demtuar për të kerkuar demshperblim dhe detyrimi i personit përgjegjës për

t'a shlyer ate. Ne interpretim te kesaj dispozite, me shkaktim te demit "*ne personin ose ne pasurine*" e te demtuarit kuptohet jo vetem lidhja ndermjet tij dhe demit, por edhe dallimi ndermjet cenimeve te natyres pasurore dhe atyre jopasurore ne te drejta dhe interesa te ligjshme te te demtuarit.

Ne thelb, me dispoziten e nenit 608 te K.Civil, ligjvenesit parashikon mbrojtjen nga fakti i paligjshem i te tretit te te drejtave te njeriut, posacerisht te te drejtave subjektive (absolute a relative) te personalitetit dhe te pronesis (reale), sikurse jane e drejta e jetes, shendetit, personalitetit, dinjitetit, familjes, jetes private, prones, veprës së krijuar etj. Ne rast te cenimit te ketyre te drejtave nga fakti i paligjshem, i demtuari gezon te drejten subjektive relative te kerkimit te demshperblimit jashtekontraktor.

Ne kete kuptim, "*cënimi i të drejtës së autorësisë*", përbën edhe vete faktin e paligjshem qe shkakton demin "*ne personin*" e te demtuarit (neni 608 i K.Civil). Ne kete rast, sikurse jane edhe rrethanat e çeshtjes objekt i ketij gjykimi, krahas dhunimit te se drejtes themelore te të demtuarit per të bërë të njohur autorësinë e veprës së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, pretendohet se është cënuar edhe besimi që kjo shtetase ka në rrethin e ngushtë dhe të gjerë shoqëror lidhur me gjendjen psikologjike pas riprodhimit pa lejen e saj të një pjese të veprës së krijuar. Keto cenime, shkaktohen ne te drejtat e personalitetit apo te pasurise se tyre, perkatesisht ne forma te ndryshme te demit jopasuror apo pasuror.

Lidhur me çeshtjen e pare per diskutim, çmohet se: në të drejtat morale të autorit, futen e drejta për autorësinë e veprës, për të vendosur emrin e tij në çdo kopje të veprës; e drejta që të mbetet anonim ose të përdorë një pseudonim, e drejta të kundërshtojë çdo lloj shtrembërimi, heqje apo ndryshimi të veprës dhe e drejta të kundërshtojë autorësinë në një vepër, kur kjo është vendosur në mënyrë arbitrare nga dikush tjetër. Të drejtat morale janë të drejta që i përkasin sferës jopasurore, e shoqërojnë autorin jo vetëm gjatë jetës së tij por edhe pas vdekjes dhe kanë natyrë personale.

Të drejtat ekonomike të parashikuara në ligjin Nr. 9380 dt. 28. 04. 2005, janë e drejta e riprodhimit, e shpërndarjes, prezantimit dhe e drejta e shfaqjes së një vepre sipas parimit të përgjithshëm se autori është edhe pronari i parë i të drejtës së autorësisë, në një vepër.

Gjykata vëren se lidhur me pretendimet e paleve në objektin e padisë, për të përcaktuar nëse një subjekt qoftë ky fizik apo juridik është autor i një vepre, duhet që ky person (autori), në krijimin e veprës së tij, të ketë shpenzuar aftësi, gjykim dhe punë, ose seleksionim, gjykim dhe përvojë, ose punë aftësi dhe kapital. Për të provuar autorësinë e një vepre duhet të ekzistojnë dy kriteret kumulative: *Së pari*, vepra duhet të jetë një krijim origjinal i autorit; *Së dyti*, autori duhet të ketë investuar një minimum aftësisish gjykimi dhe pune.

Të dyja kriteret e mësipërme, duhet të konkurojnë së bashku në të njëjtën kohë. Investimi i aftësive dhe punës në procesin e kopjimit të veprës së dikujt tjetër apo përshtatjes së saj në referim të një ideje personale, nuk mund të konfirmojë origjinalitetin e veprës. Edhe kur marrja e një vepre nga një vepër tjetër është e vogël, vepra e krijuar rishtazi mund të mos arrijë

minimumin standart të kërkuar dhe nuk gëzon mbrojtjen e të drejtës së autorit.

Në rastin konkret, e drejta e autorit mbron vepra letrare dhe vepra të tjera ku përfshihet çdo krijim original intelektual të kësaj natyre, pavarësisht nga forma e shprehjes së tij (vepër origjinale) dhe çdo krijim të prejardhur në formën e një vepre apo të një koleksioni (vepër e prejardhur).

Me vepër origjinale do të kuptojmë një krijim i cili nuk ka ekzistuar ndonjëherë në parë ose edhe nëse ka ekzistuar, paraqitet në një formë të re me elemente të reja, që e bëjnë atë të dallohet nga krijimi i mëparshëm.

Kurse me vepër të prejardhur, do të kuptohet ajo vepër e cila mbështetet në një krijim të mëparshëm, por që mbart në vetvete një punë krijuese, që gjithsesi ka natyrë përzgjedhëse dhe sistemimi.

*Originaliteti i një vepre nuk nënkupton nxjerrjen e diçkaje të re, por vetëm faktin që pretenduesi i të drejtës së autorit nuk duhet ta kopjojë punën e tij nga një person tjetër, i cili e ka mbështetur krijimin e vet mbi një material tjetër fillestar, të krijuar nga një autor tjetër. (shih Pronësia Intelektuale faqe 62 Prof. Asoc. Dr. Mariana Tutulani).*

*Kjo do të thotë se çdo vepër, pavarësisht nga fakti nëse është një krijim origjinal nga e para ose i prejardhur që është mbështetur në një material tjetër fillestar, që të jetë vepër, duhet të karakterizohet nga elemente origjinale, që nuk janë paraqitur më parë nga dikush tjetër.*

Originaliteti i një vepre qëndron në prezantimin e përpjekjeve krijuese te autorit për të na paraqitur një krijim të ri që nuk është realizuar më parë në kohë, por edhe për të ndryshuar apo përshtatur një vepër që ka ekzistuar, por në kufijtë e një pune serioze, të një përpjekjeje individuale dhe të një rezultati që sjell një frymë të re apo dicka të re në krijim, duke ruajtur idenë kryesore të veprës.

Siç rezultoi ne pretendimet e paraqitura në kerkese-padi, ne objektin e saj, e konkretisht ne piken 1, nga pala paditëse \*\*\* kerkohet shprehimisht : « Detyrimi i pales se paditur te shperbleje demin pasuror dhe moral te shkaktuar nga botimi ne menyre te padrejte ne emrin e tij dhe duke shkelur te drejten e autorit, te shkrimit me titull « Hetimi dhe gjykimi i veprave penale te trafikimit », ne « Manualin per identifikimin, trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave te trafikimit te qenieve njerezore » , e botuar ne siglen e Qendres se Sherbimeve dhe Praktikave Ligjore te Integruara » . Pra sipas këtyre pretendimeve, shkelja paditeses i ka ardhur nga botimi i padrejte i vepres se saj nga Qendra e Sherbimeve dhe Praktikave Ligjore te Integruara dhe i padituri \*\*\*. Kjo permendet edhe ne parashtrimet hyrese te paraqitura nga pala paditese ne proces, si dhe ne konkluzionet perfundimtare. Pra, demi pasuror dhe ai moral, sipas pretendimeve të ngritura, i ka ardhur paditeses per shkak te botimit te padrejte te vepres se saj ne nje emer tjetet (veprim i paligjshem dhe me faj sipas saj).

Gjykata çmon se çdokush që kryen një akt që është rezervuar ekskluzivisht për pronarin e të drejtës së autorit, do të shkelë të drejtën e autorit në vepër nëse ai ose ajo nuk ka marrë më parë lejen e pronarit të së drejtës për të kryer këtë akt. E drejta e pronarit të një vepre shkelet, nëse vepra e tij kopjohet dhe kopje të kësaj vepre, nxirren në publik.

Referuar doktrinës lidhur me të drejtën e autorit dhe rasteve praktike të saj (*Francis Day & Hunter vs Bron (1963) CH 587 Eng*), nuk do të

ndodhemi përpara një shkeljeje të së drejtës së autorit, nëse rezultati arrihet në mënyrë të pavarur dhe nëse përdoret i njëjti burim. Pronari që pretendon shkeljen e të drejtës së autorit të tij ose të saj, duhet të provojë që ngjashmëria midis veprës së tij dhe të ashtuquajturës shkelje, shpjegohet me lidhjen rastësore. Pjesë e provave të kërkuara, është që vepra e paditësit të jetë krijuar para të ashtuquajturës shkelje, gjë që përjashton mundësinë e marrjes së tematikës nga e ashtuquajtura shkelje. Nëse i padituri nuk sjell një shpjegim tjetër bindës lidhur me ngjashmërinë, atëherë gjykata do të bindet lidhur me kopjimin e kryer.

Gjykata vëren se botimi i vepres, dallon nga publikimi i saj. Nje fakt i tillë i është bërë me dije palës paditëse nga OSBE ne shkresen e saj dt. \*\*\*, në përmbajtje të së cilës është përcaktuar se Manuali është nje publikim i QPSHLI dhe jo i te paditurit \*\*\*. Botimi i vepres është nje marrredhenie kontraktore, që parashkohet në Nenin 40 të ligjit Nr. 9380 dt. 28. 04. 2005. Ky nen përcakton edhe kushtet që një vepër të quhet e botuar, nder te cilat është ekzistenca e tirazhit, pajisja me ISBN identifikuese etj.

Ne rastin konkret, nga ana e paditeses nuk është paraqitur ndonje kontrate botimi, as vertetim regjistrimi pranë ZSHDA dhe Manuali i sjelle me cilësinë e proves, nuk ka as tirazh e as ISBN.

Ne konceptin e pales paditese, veprimet e paligjshme dhe me faj te pales se paditur konsistojne ne botimin e shkrimit « *Hetimi dhe gjykimi i veprave penale te trafikimit* », ne « *Manualin per identifikimin, trajtimin dhe mbrojtien e viktimave te trafikimit te qenieve njerezore* » publikuar ne periudhen \*\*\* te vitit 2008, pa respektuar te drejten e saj te autorit, qe kjo e fundit e kishte fituar nepermjet publikimit te Temes « *Trajtimi i viktimave te trafikimit. Standarti i nevojshem ne dhenien e drejtesise* » ne dt. \*\*\*.2007. Paditesja duke iu referuar Manualit, pretendon se shkrimi i botuar nga pala e paditur ne te, është veper e saj, e shkeputur nga punimi i saj : « *Trajtimi i viktimave te trafikimit. Standarti i nevojshem ne dhenien e drejtesise* », duke u shprehur keshtu ne parashtrimet e kerkese-padise (faqe 4, paragrafi i 4) : « *Tema e trajtuar nga i padituri (i referohet shkrimit tek MANUALI) fillon nga faqja \*\*\* dhe deri ne faqen \*\*\* dhe është kopjuar ne menyre te plote nga ana e tij, pa asnje ndryshim qofte edhe strukturor. . . .* ». Me pas, po ne parashtrimet hyrese (ne paragrafin e 7 faqja 2) ajo citon « *. . . pas ketij momenti kam kontaktuar me e-mail dhe madje kemi biseduar edhe privatisht me te paditurin, pe mundesine e nje ribotimi te dyte te shkrimit (i referohet shkrimit te MANUALIT) por tashme ne bashkeautoresi me mua . . . .* ». Edhe ne rigjykim pala paditese shprehu se i ka kerkuar te paditurit ribotimin e manualit ne bashkeautorise, gje qe u pranua edhe nga pala e paditur, porse ky fakt i ribotimit te Manualit me te dy emrat, nuk prezumon bashkeautoresine ne kete veper !!! Pra edhe pse kontradiktore ne qendrim, pala paditese pranon faktin e bashkeautoresise, duke ceduar nga autoresia e vetme e punimit te kryer ne Shkollen e Magjistratures.

Gjykata vëren se në temën e punuar nga paditësja në vitin 2007 në Shkollën e Magjistraturës, është shënuar se i padituri ka qenë udhëheqës i saj në punimin e kryer. Raportet mes udhëheqësit të temës dhe hartuesit të saj, janë marrëdhënie bashkëpunimi të ndërsjelltë në temën e hartuar, në kuptim të Nenit 6 të Ligjit Nr. 9380 dt. 28. 04. 2005.

Nga ana e pales se paditur \*\*\*, u paraqitën ne gjykim me cilësinë e

provës shkresore, materiale te cilat vertetojne faktin se pala e paditur jo vetem qe ka eksperience ne fushen e trajtimit te viktimave te trafikimit dhe standartit ne dhenien e drejtesise, eshte ekspert prestigjioz ne kete fushe, por edhe ka shkruar e referuar ne seminare shume kohe perpara dates \*\*\*.2007, date në të cilën eshte bere publike tema e pales paditese « *Trajtimi i viktimave te trafikimit. Standarti i nevojshem ne dhenien e drejtesise* ».

Pala e paditur me anë të akteve shkresore të administruara ne cilesine e proves, provoi përpara gjykatës se pjesa “*Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të trafikimit*” e manualit “*Manuali për identifikimin , trajtimin dhe mbrotjen e viktimave të trafikimit*“, është punim i tij dhe mbështetet në ekspertizën e mëparshme në këtë fushë, në punime të tjera të mëparshme të të njëjtës temë si dhe në materiale e burime shkencore legale për të cilat asnjëra nga palet nuk ka të drejtën e autorit.

Gjykata veren se ndodhemi perpara autoresise se nje vepre per paditese, nese vepre e saj (paditese), eshte krijuar para të ashtuquajturës shkelje, gjë që përjashton mundësinë e marrjes së tematikës nga e ashtuquajtura shkelje. Nëse i padituri nuk sjell një shpjegim tjetër bindës lidhur me ngjashmërinë, atëherë gjykata do të bindet lidhur me kopjimin e kryer.

Referuar provave shkresore te administruara ne gjykim, gjykata arrin në përfundimin se eksperiencia e te paditurit në trajtimin procedural të viktimave të trafikimit sipas standardeve ndërkombëtare, lidhet me përvojën e tij që prej vitit 2004, si gjyqtar dhe drejtues i Gjykatës \*\*\*. Që nga kjo periudhë e në vazhdim, i padituri eshte përfshirë me cilësinë e ekspertit në disa aktivitete, ku ka patur referime të shumta të të njëjtës temë dhe natyrë. Per te provuar kete fakt u administruan gjyqësisht vertetime te pjesemarrjes ne aktivitete te ndryshme si dhe shkrimet e mbajtuar nga \*\*\* ne keto raste:

-Në vitin 2005 (\*\*\*), pala e paditur ka kryesuar grupin e eksperteve ne nje projekt te financuar nga Ambasada Amerikane e realizuar nga QAG per monitorimin e vendimeve te gjykates që kane të bëjne me trafikimin e qënieve njerëzore. Pala e paditur ka kontribuar për pjesën e gjykimit të veprave penale të trafikimeve me anë të analizave ligjore të kryera dhe për të provuar këtë fakt, eshte paraqitur ne gjykim një kopje e manualit të publikuar me këtë rast.

-Ne datën 10 tetor të vitit 2005, pala e paditur me cilesine e ekspertit, ka moderuar dhe ka referuar në një tryezë të rrumbullakët mbi antitrafikun dhe mbrotjen e dëshmitarëve, aktivitet i financuar nga USAID – ku i padituri ka mbajtur një teme : “*Mbrojtja e dëshmitarit. Pozita e vitimës dhe dëshmitarit në fazat e hetimit dhe gjykimit*“ duke u ndalur konkretisht në trajtimin e viktimave te trafikimit gjate shqyrtimit gjyqesor dhe domosdoshmerine e kompensimit te tyre. Një fakt i tillë provohet nga administrimi i këtyre provave:

-Kontratë e shërbimit mes \*\*\* (zbatues i projektit te USAID) dhe pales se paditur si ekspert.

-Punimi i tij i prezantuar në këtë tryezë “*Mbrojtja e dëshmitarit. Pozita e vitimës dhe dëshmitarit në fazat e hetimit dhe gjykimit*”. Kjo teme në pjesën e trajtimit të viktimës dëshmitare është pothuajse e njëjta me atë që pala e paditur ka trajtuar në punimin dhe “*Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të trafikimit*” pjesë e manualit “*Manuali për identifikimin, trajtimin dhe mbrotjen*

e viktimave të trafikimit” objekt i këtij gjykimi, i botuar në vitin 2008. Në gjykim rezultoi se ky aktivitet ka konkluduar me publikimin e një manuali “Manual për luftën ndaj trafikimit të personave”, të cilin pala e paditur e ka përdorur si referim për punimin e tij të mepasshem “Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të trafikimit” në manualin “Manuali për identifikimin , trajtimin dhe mbrotjen e viktimave të trafikimit” objekt i këtij gjykimi. I njëjti burim është përdorur edhe nga paditësja \*\*\* në temen e saj të diplomës, duke mbështetur pretendimin e të paditurit se kemi bashkëautorësi në temën e diplomës së hartuar prej saj me ndihmën e të paditurit në cilësinë e udhëheqësit të kesaj teme.

Ne datë \*\*\*.2006, pala e paditur ka qene me cilesine e ekspertit në një aktivitet të organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, i mbështetur nga Ambasada Hollandeze në kuadër të projektit “Drejtësia restauruese përmes krijimit të një sistemi miqësor për gratë dhe vajzat – viktimat të dhunës” ku i padituri ka mbajtur referimin “Çështja e dëmshpërblimit të viktimave në kuadër të një drejtësie restauruese”. Një fakt i tillë rezultoi i provuar nga administrimi në gjykim i këtyre provave:

-Vërtetimi i “\*\*\*”;

-Afhenda e aktivitetit dhe ftesa drejtuar të paditurit;

-Punimi dhe prezantimi i të paditurit “Çështja e dëmshpërblimit të viktimave në kuadër të një drejtësie restauruese”.

Ne datën \*\*\*.2006, pala e paditur ka marrë pjesë me cilësinë e ekspertit në një tryezë të organizuar nga OSBE me temen “Mundësia për t’iu drejtuar organeve të drejtësisë dhe shpërblimi i dëmit për viktimat e trafikimit” organizuar nga OSBE. Detyra e kësaj pale në këtë tryeze ishte të prezantonte temen “Trajtimi i viktimave gjatë procedimit penal. Standard i nevojshëm i drejtësisë. Mundësia që ofron legjislacioni shqiptar për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit dhe çfarë mund të ndryshohet”. Në kete teme pala e paditur ka trajtuar gjerësisht trajtimin e viktimave, kompensimin e viktimave, mundesine e tyre për kompensim etj, duke provuar në këtë mënyrë se punimi i paditëses është shumë i ngjashëm me materiale të hartuara dhe të përdorura nga i padituri në një periudhë të mëparshme se sa kryerja e punimit “Temë diplome Trajtimi i viktimave të trafikimit, Standard i nevojshëm në dhënien e drejtësisë” prej saj. Një fakt i tillë u vërtetua nga provat si më poshtë vijon:

-Programi dhe informacioni baze i aktivitetit të datës \*\*\*.2006 të OSBE;

-Vertetimi dhe marreveshja e shërbimit special mes pales se paditur si ekspert dhe OSBE si dhe termat e references se kesaj marreveshje, nga ku del qe pjesmarrja e të paditurit në kete aktivitet, kishte si qellim përgatitjen e një prezantimi në lidhje me viktimat e trafikimit;

-Punimi i pales se paditur: “Trajtimi i viktimave gjatë procedimit penal. Standard i nevojshëm i drejtësisë. Mundësia që ofron legjislacioni shqiptar për dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit dhe çfarë mund të ndryshohet” i prezantuar në kete tryeze etj.

Gjithashtu në cilesine e proves dhe në mbështetje të prapësimeve të pales se paditur lidhur me të drejtën e autoresise se pales paditese, u depozituan në proces materiale shkencore, të cilat kanë shërbyer si baze referimi për shkrimin « Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të trafikimit », »

pjesë përbërëse e «Manualit per identifikimin, trajtimin dhe mbrojtien e viktimave te trafikimit te qenieve njerezore ». Sipas provave:

-Manual i OSBE-ODHIR;

-Manual “Mekanizmat kombetare te referimit”, botim OSCE;

-Dosje e Marreveshjes se bashkepunimit per krijimin e nje Mekanizmi Kombetar Referues per identifikimin dhe asistence te permiresuar per viktimat e trafikimit te qenieve njerezore;

-Manual per luften ndaj trafikimit te personave, financuar nga USAID – rezultat i tryezes se rrumbullaket ku i padituri ka marrë pjesë ne vitin 2005;

-Program per fuqizimin e kunderveprimeve anti-trafikim ne Europen Juglindore ,

-Nje cikel leksionesh te nje kursi mbi kuptimin e vepres penale te trafikimit te qenieve njerezore;

-Pjese teorike e se drejtes se detyrimeve etj te paraqitura nga pala e paditur, provohet se Shkrimi « Hetimi dhe gjykimi i veprave penale te trafikimit » ne « Manualin per identifikimin, trajtimin dhe mbrojtien e viktimave te trafikimit te qenieve njerezore », i cili konsiderohet nga ana e pales paditese si « veprim i paligjshem dhe me faj ne cenimin e se drejtes se saj te autoresise », eshte produkt i punes kerkimore e shkencore te pales se paditur, e materializuar ne aktivitetet dhe shkrimet e mesiperme.

Ne kete menyre konkludohet per gjykatën se nuk jemi perpara shkeljes se te drejtes se autoresise nga pala e paditur ndaj pales paditese.

Ne zbatim te nenit 609 te K.Civil per pranimin e pergjegjesise civile jashtekontraktore, duhet te vertetohet lidhja shkakesore *materiale* ndermjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) se paligjshme e me faj dhe demit te shkaktuar. Ne vijim, per percaktimin e demtimeve (cenimeve) konkrete qe rrjedhin nga ky fakt i paligjshem dhe caktimin e demshperblimit perkates, duhet te vertetohet edhe lidhja shkakesore *juridike* ndermjet tyre.

Nepermjet lidhjes shkakesore *materiale*, vertetohet se cili eshte personi pergjegjes (subjekti aktiv) dhe lidhja shkak-pasoje ndermjet tre elementeve objektive e subjektive te faktit te paligjshem (ngjarjes se demit): sjelljes se paligjshme (objektiv) e me faj (subjektiv) dhe pasojes se ardhur prej tyre, pra demtimit te nje tjetri ne personin a pasurine e tij (objektiv). Ne kete rast zbatohet parimi juridik *condicio sine qua non*, sipas te cilit, ardhja e pasojes se demshme nuk do te vertetohet nese nuk do te kishte ndodhur shkak, sjellja e paligjshme dhe me faj e personit pergjegjes per shkaktimin e demit.

Ndersa, me lidhjen shkakesore *juridike* vertetohet lidhja shkak-pasoje ndermjet faktit te paligjshem ne teresine e tij dhe cenimeve konkrete te pesuara ne te drejta dhe interesa te ligjshme, si te subjektit pasiv mbi te cilin ka vepruar direkt ky fakt i paligjshem, ashtu edhe te personave te tjere qe rezultojne te demtuar si rrjedhoje e pasojave qe pranohet se vijne normalisht e zakonisht nga i njejti fakt te paligjshem, sipas parimeve te rregullshmerise dhe eficiences se lidhjes shkakesore (*id quod plerumque accidit*).

Ne kete kuptim, lidhja shkakesore nuk nderpritet nese pas vertetimit te faktit te paligjshem dhe pasojes “natyrale”, “materiale”, te ardhur prej tij, pra demtimit (cenimit) te interesave te ligjshme te subjektit pasiv nga sjellja



e shkaktuesit të demit, vijojnë e vertetohen fakte të reja me pasoja të demshme, të cilat konsiderohen të lidhura e rrjedhojë direkte dhe e menjehershme e të njëjtit fakt të paligjshëm, përderisa provohet që nëse ky nuk ndodhte, fakti i ri, i mevonshëm, në vetvete, nuk mund të shkaktonte edhe ai të njëjten pasojë të demshme.

Në rastin e çështjes objekt gjykimi, rezultoi se nuk vertetohet lidhja shkakesore materiale ndërmjet sjelljes së paligjshme e me faj të palës së paditur, në formën e hartuesit të mëparshëm të materialit « *Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të trafikimit* » në « *Manualin për identifikimin, trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore* » dhe demit pasuror dhe jopasuror të pretenduar si të shkaktuar paditeses. Ky dem jo vetëm që mbeti i paprovuar gjyqësisht me anë të provave shkresore të depozituara nga paditësjja, por edhe nuk ka asnjë lidhje shkakesore me ndonjë nga veprimet e kryera nga i padituri, për sa kohë që në gjykim u provua se ky i paditur në cilësinë e udhëheqësit të temës së paditëses, e ka hartuar shumë kohë më parë se kjo palë, shkrimin objekt gjykimi.

Dispozita e nenit 625 të K.Civil interpretohet e zbatohet në pajtim dhe harmoni me parimet themelore kushtetuese mbi të drejtat e njeriut, duke mbajtur parasysh dhe reflektuar në gjykim edhe vetë procesin dinamik të ndergjegjesimit e të emancipimit të shtetit e të shoqërisë në njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Sikurse është trajtuar me siper në këtë vendim, sipas neneve 3, 15 e vijues të Kushtetutes, parashikohet mbrojtje e *posaçme dhe e barabarte* e të mirave pasurore dhe atyre jopasurore të njeriut. Në këtë kuptim, edhe neni 608 e vijues i K.Civil synon riparimin e plote të *çdo demit* të pesuar në mënyrë të paligjshme, pra jo vetëm në pasurinë në kuptimin e ngushtë ekonomik, por edhe në të mirat jopasurore që meshirojnë *vlerat e vetë njeriut*.

Demi jopasuror, i parashikuar në nenin 625 të Kodit Civil, si një kategori e gjere dhe gjithëpërfshirëse e demeve jashtekontraktore, përfshin çdo lloj demit të pesuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jopasurore që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vleresimi të drejtperdrejte ekonomik në treg. Në thelbin e saj, kjo dispozitë njihet të drejtën e demshperblimit për çdo lloj demit jopasuror jashtekontraktor, i cili është *“i ndryshëm nga ai pasuror”*.

Gjithashtu nga interpretimi i pg.II i nenit 608 të K.Civil rezultoi se, është i padituri, ai që ka barrën e provës (*onus probandi*), për të provuar faktin se nuk ka faj në dëmin që i është shkaktuar paditësit, si rezultat i veprimit të tij. Ky është një përjashtim nga rregulli i sanksionuar në nenin 12 të K.Pr.Civile (rregull i njohur njohur qartë dhe shumë herët nga jurisprudenca dhe doktrina shqiptare).

Në Republikën e Shqipërisë (më poshtë RSH) të drejtat e individëve, gëzojnë një mbrojtje maksimale si nga Kushtetuta, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (më poshtë Konventa), ashtu edhe nga ligjet e tjera. Midis të drejtave të tjera të garantuara nga këto akte normative të sipërcituara, është edhe e drejta e autorit si morale ashtu edhe ekonomike. Kjo është një nga të drejtat themelore të garantuara nga Ligji Nr. 9380 dt. 28.04.2005 .

Janë pikërisht këto të drejta dhe liri themelore të personave, të cilat janë të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik (neni 15 i Kushtetutës së RSH).

Ne rastin konkret, e demtuara nuk arriti te provonte në gjykim shkaktimin e demit moral me ane te prezumimit te thjeshte se, botimi i materialit « *Hetimi dhe gjykimi i veprave penale te trafikimit* » ne « *Manualin per identifikimin, trajtimin dhe mbrojtien e viktimave te trafikimit te qenieve njerezore* », i ka shkaktuar paditëses dëm moral në kuptim të dispozitës së sipërcituar. Për sa kohë që ky material është punim i përbashkët i saj dhe të paditurit (fakt i cili provohet gjyqësisht nga administrimi i shumë materialeve të tjera te ngjashme të hartuara nga i padituri si autor në një periudhë të mëparshme), pretendimi i kësaj pale për sa i përket demit moral të shkaktuar, mbeti i paprovuar gjyqësisht.

Ne parim, përveç prezumimit te thjeshte mbi ardhjen e pasojës morale të cënimit të personalitetit dhe emrit të mirë në shoqëri, për caktimin e masës së demshperblimit, gjykata mban parasysh se çdo individ qoftë ky person fizik apo juridik, ka personalitetin e tij, unik dhe te ndryshem nga te tjeret. Prandaj, edhe shkalla e vuajtjes së pasojave dhe masa konkrete e demshperblimit, mund te ndryshojë rast pas rasti. Për këte qëllim, gjykata shqyrton edhe rrethana konkrete të çështjes për të çmuar se pari shkallen efektive të dëmit të shkaktuar dhe, në lidhje me të, natyrën e faktit të paligjshëm apo rrezikshmerinë e saj, nëse përben veprë penale, shkallen e fajësise dhe në teresi mënyrën e sjelljes së shkaktuesit të demit në raport me ngjarjen dhe personat e cenuar, natyrën e së drejtës së cenuar dhe të pasojave të shkaktuara nga fakti i paligjshëm, kushtet subjektive të demtuarit si rëndësia që ka ai në shoqëri dhe në rrethin e gjyqtarëve, juristëve dhe studentëve të Shkollës së Magjistraturës dhe shkalla individuale e ndjeshmerisë ndaj cënimit të pesuar, si dhe rrethanat që lidhen me kushtet sociale dhe ekonomike të demtuarës, por pa cenuar në këte rast parimin kushtetues të barazisë para ligjit dhe të ndalimit të diskriminimit të njeriut për shkak të gjendjes sociale, ekonomike, etj., në zbatim të nenit 18/2 të Kushtetutës. Shuma e demshperblimit për demin moral, për shkak të natyrës subjektive dhe të brendshme të tij, nuk mund të llogaritet mbi tabelë dhe skemë të parallogaritura vetëm për këte qëllim. Prandaj, gjykata e cakton atë mbështetur në parimin e dhenies së drejtësisë sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në teresinë e tyre, duke u mbështetur edhe në kritere eventuale normative të zbatueshme sipas natyrës së të drejtës së cenuar ose, në mungesë të tyre, në kritere dhe elemente vlerësimi të konsoliduar nga praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve analoge ose në përvoja të perkatese jashtëgjyqësore, duke patur gjithnjë parasysh zhvillimin aktual ekonomik e social të vendit, përfshirë vlerën e parësive në ekonominë kombëtare.

Ne rastin konkret, Gjukata vëren se, nga provat e paraqitura në proces, nuk rezultoi që paditësjë \*\*\* të këte pesuar një dem pasuror, pakesim të pasurisë së saj, por as edhe fitim të munguar. Do të ndodheshim përpara një dëmi me karakter pasuror nëse punimi i saj « *temë diplome* », do të ishte në shitje dhe kjo e fundit do të ishte pakesuar nga nxjerrja në shitje e Manualit të të paditurit, fakte të cilat në të vertetë nuk ekzistojnë.

Në konceptin e palës paditëse, veprimet e paligjeshme dhe me faj të palës së paditur konsistojnë në botimin e shkrimit « *Hetimi dhe gjykimi i veprave penale te trafikimit* », në « *Manualin per identifikimin, trajtimin dhe*

*mbrojtien e viktimave te trafikimit te qenieve njerezore » publikuar ne periudhen \*\*\* te vitit 2008, pa respektuar te drejten e saj te autorit, qe kjo e fundit e kishte fituar nepermjet publikimit te Temes « Trajtimi i viktimave te trafikimit. Standarti i nevojshem ne dhenien e drejtesise » ne \*\*\*,2007. Teorikisht, veprimi i paligjshem dhe me faj, jane kritere komplementare ne ekzistencen e institutit te shkaktimit te demit, ku te dy kane te bejne me sjelljen e demtuesit, por paligjshmeria eshte kategoria objektive, ndersa faji eshte kategoria subjektive e veprimit te demtuesit. Keto kritere duhet te egzistojne ne menyre kumulativo-plotesuese, dhe duhet te provohen nga pala kerkuese. Ne pergjegjesine jashtekontraktore do te kuptohet veprimi i paligjshem, sjellja e subjektit te demit qe konsiston ne veprim (*commissio*) ose mosveprim (*ommissio*), qe cenon nje marredhenie te posacme te se drejtes private te mbrojtur posacerisht me ligj. Qe ky veprim ose mosveprim te konsiderohet i paligjshem ne kete kuptim, duhet qe te provohet marredhenia e ligjeshme e cila ka prodhuar te drejta pasurore dhe morale per palen paditese, te drejta keto qe jane cenuar nga veprimi i pales se paditur. Ky provim eshte i paplote pasi njekohesisht me paligjshmerine e veprimeve, paditesi duhet te provoje edhe fajin, i cili zakonisht, ne rastet e pergjegjesise jashtekontraktore shfaqet ne formen e dashjes ose pakujdesise se rende, element i cili mbeti krejtësisht i paprovuar gjyqësisht.*

Nga ana e pales se paditur, u sollen ne proces prova shkresore te cilat vertetojne faktin se pala e paditur jo vetem qe ka eksperience ne fushen e trajtimit te viktimave te trafikimit dhe standartit ne dhenien e drejtesise, por edhe qe ka shkruar e referuar ne seminare, shume kohe perpara dates \*\*\*,2007, date qe eshte bere publike tema e pales paditese « Trajtimi i viktimave te trafikimit. Standarti i nevojshem ne dhenien e drejtesise ».

Në këto kushte, gjykata çmon se pretendimi i plës paditëse lidhur me cënimin e të drejtës së autorësisë së saj dhe demit te shkaktuar si rezultat i kesaj shkeljeje, është i pambështetur në ligj e në prova e si i tillë duhet rrëzuar.

Per sa me lart u arsyetua, gjykata çmon se kerkese-padia duhet rrezuar teresisht, pasi eshte e pa bazuar ne ligj dhe ne prova.

#### **PER KETO ARSYE :**

Gjykata bazuar në Nenet 126, 306-308 e vijues te K. Pr. Civile,

#### **VENDOSI :**

1. Rrëzimin e kërkesë-padisë si të pa bazuar në ligj dhe në prova.
2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.
3. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim ne Gjykatën e Apelit Tiranë, brënda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e ditës së komunikimit të vendimit për palët në mungesë.
4. **U shpall sot më datë 08. 02. 2016 në Tiranë.**

**SEKRETARE**

**LUSJANA IDRIZI**

**GJYQTAR**

**ERVIN POLLOZHANI**

**Shpenzimet gjyqësore**

**Taksë padie**

**\*\*\* Lek**

**Takse padie 3%**

**\*\*\* Lek**

**Shpenzime njoftimi llog gjykates**

**\*\*\* Lek**

**Totali**

**\*\*\* Lek**